# TË DREJTAT TONA



Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës thotë se: Fëmijë është çdo krijesë njerëzore nën moshën e pjekurisë. Ne, fëmijët, kemi të drejtë t'i njohim të drejtat tona. Të gjitha shtetet janë të detyruara t'i respektojnë të drejtat e fëmijës dhe t'i mbrojnë interesat tona afatgjata.


18
15
10
5
1

Ne, fëmijët, kemi të drejtën e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit. Kemi të drejtën e ushqimit të mjaftueshëm dhe ujit të pijshëm të pastër.



Me të lindur, ne kemi të drejtë të na vendoset një emër dhe të fitojmë shtetësinë përkatëse, pa marrë parasysh vendqëndrimin tonë.



Ne, fëmijët, kemi të drejtë të jetojmë me prindërit e familjet tona apo me ata, të cilët përkujdesen për ne më së miri.



Askush nuk ka të drejtë t'i diskriminojë fëmijët duke u bazuar tek prejardhja e tyre gjinore, racore, gjuhësore, fetare, kombëtare ose etnike.



Ne, fëmijët, kemi të drejtën e arsimimit dhe të arsimit fillor falas.



Na dëgjoni neve, fëmijëve, sepse ne kemi të drejtën e shprehjes së mendimit tonë.



Ne, fëmijët, kemi të drejtën e shërbimeve të kujdesit shëndetësor.



Fëmijët me nevoja të veçanta kanë të drejtën e përkujdesjes së posaçme.



Nëse ne, fëmijët, jemi refugjatë dhe të huaj në vende të treta, ne kemi të drejtën e përkujdesjes së duhur dhe të mbrojtjes.



Ne, fëmijët, kemi të drejtë për të pushuar, për të luajtur si dhe të përfshihemi në veprimtari argëtuese.



Ne, fëmijët, kemi të drejtën e mbrojtjes nga të gjitha format e dhunës dhe të keqtrajtimit.



Ne, fëmijët, nuk duhet të përdoremi si krah pune, aq më tepër kur kjo gjë cënon shkollimin tonë.



SLOVENIA
DEVELOPMENT COOPERATION

REPUBLIC OF SLOVENIA
EMBASSY SKOPJE

Биро за развој на образованието

CENTER FOR HUMAN RIGHTS AND CONFLICT RESOLUTION

Ministria e punëve të jashtme dhe evropiane e Republikës së Sllovenisë

**TË DREJTAT TONA**
është një mjet mësimor për edukimin e të drejtave të fëmijëve
10-12 vjeçarë.

Botues:
Ministria e punëve të jashtme dhe evropiane e Republikës së Sllovenisë
Preshernova 25
1000 Lubjanë
Slloveni

Autorë:
Liana Kallçina
Andreja Barle Llakota
Zoran Pavloviç
Mitja Sardoç

Ilustrues: Matjazh Shmid
Dizenjues: Jasha Shmid

2025